



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	07.07.2026 <u>01-01/01-32212</u>
Për:	Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për mbështetje financiare për KFC "Vëllaznimi"

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Gjakovës, dispozitave të Rregullores me Nr. 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-v, Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, si dhe Rekomandimit të Komisionit Vlerësues, me datën 07.07.2026 e parashtrohet në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për mbështetje financiare të KFC "Vëllaznimi" në Gjakovë, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të aktiviteteve të këtij klubi, të rekomanduar nga Komisioni Vlerësues, sipas thirrjes publike për projekte/programe të OJQ-ve, në fushën e Sportit.
2. Mjetet për mbështetje financiare për KFC "Vëllaznimi" të ndahen nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport nga kodet buxhetor 632/85016/20 në vlerë prej 40,000€.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për ekzekutimin e mjeteve financiare sipas pikës së dytë të këtij Propozim -Vendimi.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Data:	01.07.2026
Për:	z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Komisioni Vlerësues në Fushën e Sportit
Përmes:	Adea Roka Pylla – drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport
Tema:	Rekomandim



I nderuari z. Kryetar,

Në procesin e Thirrjes Publike për mbështetje financiare të projekteve / programeve për OJQ-të në fushën e sportit të hapur nga DRKS, është pranuar edhe kërkesa e KFC “Vëllaznimi”.

Meqë, KFC “Vëllaznimi” veprimtarinë sportive e bazojnë në Planin Vjetor të Punës, për realizimin e së cilës kërkohet vlerë e lartë e mjeteve financiare për subvencionim, gjithashtu duke u bazuar në historikun e gjatë të klubit dhe impaktin e tyre tek komunitetin në përgjithësi, si dhe nevojave të vazhdueshme për realizimin e qëllimit të klubit për futjen në superligë dhe avancimin e të gjitha grup moshat, talenteve të rinj dhe futbollit në përgjithësi, Komisioni ka propozuar që për realizimin e këtij projekti, të rekomandoj shumë në vlerë prej 40.000 euro.

Andaj, rekomandojmë kryetarin e Komunës që të aprovoj shumë e lartëcekur dhe të njëjtën ta procedoj për miratim në Kuvendin Komunal.

Gjeni të bashkangjitur:

Projekt - Aplikacionin për mbështetje financiare të parashtruar nga KFC “Vëllaznimi”.

1. Labinot Efendiu – Kryesues
2. Shpend Kumnova – Anëtar
3. Kujtesa Karaxha – Anëtare
4. Florentina Thaqi Muqaku – Anëtare
5. Bekim Sylja – Anëtar

Me respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591
kk.rks-gov.net/gjakove/